




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR Durrës
ZYRA VENDORE ARSIMORE, TIRANË
SHKOLLA E MESME “PETRO NINI LUARASI ”

Tiranë, më 11.05.2020

UDHËZUES PËR “QËNDRIMIN DHE LËVIZJEN NË SHKOLLË”(COVID-19)

SHKOLLA E MESME “PETRO NINI LUARASI ”



A.1 PJESËMARRËSIT NË HARTIMIN TË RREGULLORES

✚ Teuta Bracaj	Kryetare/Drejtores
✚ Ekipi kurrikular i shkollës	
✚ Ketrin Kaskaviqi	Anëtar/Kryetari i Bordit të shkollës
✚ Zylyftar Plaku	Anëtar/Përfaqësues i këshillit të prindërve
✚ Gridi Pasho	Anëtar/President i Qeverisë Nxënësve
✚ Dorela Hasa	Anëtare/ Psikologjia e shkollës
✚ Natali Xhani	Oficere e sigurisë

A.2 GRUPET E PUNËS NË ZBATIM

- ✚ Teuta Bracaj **Drejtores (monitoron oborrin e shkollës, katin e parë ,të dytë, të tretë dhe zbatimin e kësaj rregulloreje)**
- ✚ Dorela Hasa **Psikologjia e shkollës**
- ✚ Natali Xhani, Indrit Fagu, Ledio Cenga, mjeket e shkollës, **përgjegjës për hyrjen e nxënësve në oborrin dhe ambientet e shkollës .**
- ✚ **Mësuesit përgjegjës sipas kateve:** (Arben Feshti, Yllka Ceka, kati i parë; Rudina Omari, Ertugel ,Kika kati i dytë ; Altin Lika , Enerida Mema, kati i tretë)

B. LEGJISLACIONI

- ✚ Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- ✚ Ligji nr. 69/2012 për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë i azhornuar;
- ✚ Urdhëri nr 31 datë 28.01.2020 për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.
- ✚ Urdhëri Nr 97 datë 19.03.2020 për ndërprejen e procesit mësimor në të gjitha Institucionet Arsimore Publike dhe Jopublike;
- ✚ Urdhër nr 45, datë 29. 04.2020 “Për organizimin e mësimi, vlerësimin e nxënësve dhe mbylljen e vitit shkollor 2019 - 2020, për klasën XII;
- ✚ Udhëzues Nr.Prot.496/12 për “Qëndrimin dhe lëvizjet në shkollë (COVID-19)”
- ✚ Urdhër Nr 289, datë 04.05.2020 për miratimin e udhëzuesit për “Masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmarin institucionet arsimore”, të MSHMS;
- ✚ Dokumentit për njohje dhe zbatim të Urdhërit Nr 289, ” të MSHMS, datë 04.05.2020 për miratimin e udhëzuesit për “Masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmarin institucionet arsimore”, dërguar nga MASR me Nr. Prot 2585, datë 09.05.2020;
- ✚ Rregullorja e Brendshme e Shkollës 2019-2020;
- ✚ Kodi i etikës së mësuesit.

C. UDHËZUES PËR “QËNDRIMIN DHE LËVIZJET NË SHKOLLË (COVID-19)”

C.1 PËR NXËNËSIN

C.1.1 Hyrja dhe dalja nga ambientet e shkollës

✚ Orari për hyrjen e nxënësve në shkollë rregullohet sipas grafikut, hartuar nga drejtoria e shkollës nën monitorimin e mësuesve të kujdestarisë ditore/javore. Në orën **8.00** orari për hyrjen e nxënësve në shkollën .

NDARJA E MATURANTËVE SIPAS LËNDËVE ME ZGJEDHJE

Gjithsej 403 nxënës.


Numri i klasave Ekonomi 18 klasa = 209 nxënës

Numri i klasave Qytetari dhe Psikologji 8 klasa = 87 nxënës

Numri i klasave Biologji 7 klasa = 74 nxënës

Numri i klasave fizikë 3 klasa = 30 nxënës

2 nxënës Histori dhe 1 nxënës Kimi



EMER	ATESI	MBIEMER	NDARJA NE KLASA	BANKA KU DO ULEN	LENDJA ME ZGJEDHJE
Orges	Genci	Ismaili	KL.3 / KATI 2	1	EKONOMI
Pamela	Paulin	Toma	KL.3 / KATI 2	2	EKONOMI
Xheldi	Kastriot	Xeba	KL.3 / KATI 2	3	EKONOMI
Xhersido	Aleks	Hajdari	KL.3 / KATI 2	4	EKONOMI
Arjes	Agim	Kola	KL.3 / KATI 2	5	EKONOMI
Demetra	Josif	Guçi	KL.3 / KATI 2	6	EKONOMI
Fabio	Edmond	Linxa	KL.3 / KATI 2	7	EKONOMI
Flamur	Viktor	Spata	KL.3 / KATI 2	8	EKONOMI
Flori	Adrian	Batusha	KL.3 / KATI 2	9	EKONOMI
Henri	Nazmi	Karreci	KL.3 / KATI 2	10	EKONOMI
Juna	Benard	Shehu	KL.3 / KATI 2	11	EKONOMI

C.1.2 Rregullat qe duhen te ndiqen

- Nxënësit paraqiten në shkollë duke respektuar me përpikëri orarin e komunikuar nga mësuesi kujdestar i tyre.
- Nxënësit hyjnë në shkollë, pasi janë vendosur në rradhë një nga një, me largësi dy metra, sipas shenjave dalluese të përcaktuara nga drejtoria e shkollës . (shih figurën ilustruese).



Shënim :

- Oborri i shkollës është i vijëzuar duke respektuar distancimin fizik (2 metra).

- Nxënësi që ka simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në shkollë, njofton mësuesin kujdestar, i cili në bashkëpunim me mjekun e shkollës ose atë të familjes, verifikon nëse nxënësi është i sëmurë apo jo.
- Justifikimi i mungesës bëhet vetëm nga mjeku i familjes.

- ✚ Personeli mjekësor i shkollës (mjekja, ndihmës mjekja dhe stomatologia e shkollës), i caktuar nga drejtori, duhet të kryejë vlerësimin për nxënësin si më poshtë:
 - ❖ Matje të temperaturës me termometër digjital;
 - ❖ Sprucimi me alkool 60% ose dezinfektantë të tjerë në duar;
 - ❖ Duhet të kontrollohen të gjithë nxënësit që të jenë të pajisur me maskë një përdorimshme ose mbrojtëse të fytyrës prej tekstili (maskë) të cilat duhen të lahen në 60 gradë dhe të hekurosen, si dhe shami letre për higjenën e hundëve;
- ✚ Përpara hyrjes në ambientet e brendshme të shkollës, do të vendosen **vaska, sfungjer** me solucion dezinfektues me bazë të klorit aktiv, për dezinfektimin e shuajve të këpucëve;
- ✚ Nuk lejohet që nxënësit të dalin nga godina dhe të rikthehen përsëri në të, brenda ditës;
- ✚ Dera e shkollës do të qëndrojë e mbyllur, ndërsa dritaret e klasave ku zhvillohet procesi mësimor, do të qëndrojnë të hapura për të krijuar ajrosjen e nevojshme brenda tyre.
- ✚ Lejohet vetëm një hyrje dhe një dalje në ndërtesën e shkollës.
- ✚ Dalja nga ambientet e shkollës do të bëhet sipas rregullave, duke ruajtur distancimin social dhe fizik si me lart (2 metra), nën mbikëqyrjen e mësuesve kujdestarë, mësuesve dezhurnë dhe të punonjësve të tjerë të shkollës (shih skemat ilustruese).



C.1.3 Qëndrimi dhe mësimi në klasa

- ✚ Gjatë procesit mësimor, mësuesit qëndron në klasë, duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit dhe mësuesit e tjerë (në 2 metra).
- ✚ Brenda klasës, nxënësit qëndrojnë të ulur në banka të paktën 2 metra larg njëri-tjetrit (shih fotot ilustruese).



- ✚ Mësuesit sigurohen që në klasë, të gjithë të jenë të pajisur me maskë dhe t'i mbajnë rregullisht ato.
- ✚ Nxënësit ndalohen të dalin nga klasa gjatë orëve të mësimit përveç rasteve kur i duhet të përdorin tualetet. Në këtë rast nxënësit duhet të shoqërohen.
- ✚ Çanta me librat e nxënësit mbahen në shkollë (nxënësit nuk e marrin çantën nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas).
- ✚ Nuk lejohet ushqimi në klasë.

C.1.4 Lëvizjet në mjediset e brendshme të shkollës

- ✚ Lëvizja e nxënësve në klasa, laboratorë, palestra dhe nëpër korridore duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë që çdo zonë të ketë numrin më të vogël të individëve që lëvizin në të. Kjo do të thotë, p.sh., nxënësit e klasës së 1 do të hyjnë në sallën e përcaktuar për nxënësit e kësaj klase, do të përdorin vetëm tualetin në korridorin ku ndodhet klasa e tyre, pa u takuar asnjë moment me nxënës të klasave të tjera.
- ✚ Rregullat për lëvizjen e nxënësve janë të afishuara në ambientet e klasave dhe korridoreve.
- ✚ Nuk lejohet qëndrimet në korridore.
- ✚ Nxënësit të mbajnë largësinë minimale 2 metra nga njëri-tjetëri kur lëvizin në korridore.
- ✚ Komunikimi, në rast nevojë, i nxënësit me drejtuesit, sekretarinë dhe stafin mësimor, do të kryhet nëpërmjet mësuesit përgjegjës të katit, duke respektuar distancimin social e fizik dhe rregullat e tjera të përcaktuara më lart. Mund të jetë edhe nëpërmjet telefonit apo kompjuterik, kur nxënësi nuk ndodhet në klasë.
- ✚ Nuk do të përdoren material të printuara, përveçse rasteve kur nxënësit kanë libra të cilat i mbajnë tek sendet personale, ose në shtëpi.
- ✚ Nuk do të përdoren sende personale të panevojshme për procesin mësimor.
- ✚ Nuk do të kontaktohen personat që mund të jenë të pranishëm në mjediset e shkollës.



C.1.5 Kujdesi për higjenën

- ✚ Nxënësit të ndërgjegjësohen dhe të mbahen në komunikim të vazhdueshëm për rëndësinë që ka distancimi fizik dhe higjena personale në ambientet brenda dhe jashtë shkollës, nëpërmjetë mesazheve sensibilizuese të shpërndara nga ekipi mjekësor dhe shërbimi psiko-social i shkollës.
- ✚ Stafii mjekësor i shkollës do të asistojë çdo ditë për këshillim dhe monitorim të zbatimit të rregullave të higjenës, larjen e duarve, mënyrën e kollitjes dhe tështitjes.
- ✚ Çdo nxënës në shkollë duhet të lajë duart pas çdo veprimi që mund të përbëjë rrezik për përhapjen e virusit: prekja e hundës, syve, gojës etj.
- ✚ Gjatë qëndrimit në ambientet e shkollës, çdo individ duhet të mbajë detyrimisht maskë.
- ✚ Dritaret duhet të mbahen të hapura, ose të paktën klasat të ajrosen 5-6 herë gjatë kohës së mësimi.
- ✚ Janë të ndaluara takimet dhe mbledhjet ballë për ballë në ambientet e shkollës.
- ✚ Nëse nxënësi manifeston gjendje stresi dhe ankthi, ai i drejtohet shërbimit psiko-social të shkollës nëpërmjet mësuesit kujdestar dhe “Këndit të psikologut” online pranë DRAP-së.
- ✚ Në një klasë apo sallë laboratori të mos qëndrojnë më shumë nxënës sesa mund të qëndrojnë në atë mjedis, duke respektuar distancimin social dhe fizik.
- ✚ Aktivitetet jashtëshkollore, sportive e artistike në grup janë të ndaluara.
- ✚ Janë të afishuara në të gjitha ambientet e shkollës postera mbi masën e parandalimit të infeksionit COVID-19, postera me mesazhe të qarta dhe të thjeshta dhe postera të veçantë për mënyrën e larjes së duarve.
- ✚ Do të kryhet dezinfektimi i çdo klase, çdo ditë. Pas përfundimit të procesit mësimor, të kryhet pastrimi i sipërfaqeve dhe orendive me lëndë dezinfektuese.
- ✚ Në fund të çdo dite do të kryhet denzifektimi i mjediseve të përbashkëta të shkollës.
- ✚ Do të pranohen në ambientet e shkollës vetëm nxënësit që do të firmosin rregulloren mbi parandalimin e përhapjes së COVID-19.
- ✚ Përpara se të rifillojnë mësimin në ambientet e shkollës, sipas rregulloreve të reja për parandalimin e përhapjes së COVID-19, nxënësit duhet të plotësojnë Formularin e Vetëdeklarimit për situatën e tyre shëndetësore dhe të familjarëve të tyre, e cila shërben për të hetuar paraprakisht mundësinë e një vatre infeksioni COVID-19.
- ✚ Nxënësit që nuk zbatojnë rregulloren, trajtohen me masë sipas rregullores së shkollës.

C.2 PËR MËSUESIT

- ✚ Mësuesi paraqitet në shkollë orën e përcaktuar nga drejtoria, 20’ përpara ardhjes së nxënësve.
- ✚ Mësuesit e kujdestarisë ditore/javore paraqiten në shkollë në orën e përcaktuar nga drejtoria e shkollës (30’ përpara ardhjes së nxënësve).
- ✚ Psikologjia e shkollës, e caktuar nga drejtori dhe të trajnuar për veprimet e mëposhtme, kryen për çdo nxënës procedurën si më poshtë:
 - ❖ Mat temperaturën me termometër digjital.
 - ❖ Spërkat solucionin dezinfektues me përmbajtje 70% alkool në duart e nxënësve dhe stafit.
 - ❖ Kontrollon nëse çdo nxënës është i pajisur me maskë.

- ✚ Mësuesi mban gjatë orarit zyrtar maskën, dorezat dhe solucione dezinfektuese.
- ✚ Gjatë orës së mësimit, mësuesi qëndron në klasë duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësin.
- ✚ Mësuesi largohet nga institucioni vetëm me miratimin e drejtorit të shkollës.

C.3 PËR PERSONELIN NDIHMËS

C.3.1 Sanitaret

- ✚ Personeli ndihmës paraqitet në institucionin arsimor në orën e përcaktuar nga drejtoria e shkollës (60' përpara ardhjes së nxënësve).
- ✚ Sanitaret të mbajnë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat dhe solucione dezinfektuese.
- ✚ Korridoret pastrohen çdo dy orë.
- ✚ Tualetet pastrohen e dezinfektohen çdo 30 minuta.
- ✚ Rezervuarëve të ujit të shkollës, u hidhet klor sipas udhëzimeve përkatëse çdo ditë.
- ✚ Doreza e çdo klase dhe mjedisi pune si dhe parruket e shkollëve dhe vende të tjera të pastrohen dhe dezinfektohen çdo 30 minuta.
- ✚ Largimi nga institucioni arsimor bëhet pas përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit të çdo mjedisi të tij.
- ✚ Kryhen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit dhe mësuesit.

C.3.2 Roja i Institucionit Arsimor

- ✚ Roja i shkollës paraqitet në institucionin arsimor në orën e përcaktuar nga drejtoria e shkollës (120' përpara ardhjes së nxënësve në shkollë).
- ✚ Roja i shkollës do të mbajë gjatë gjithë orarit të punës maskë, doreza dhe solucion dezinfektuese.
- ✚ Roja i shkollës nuk lejon prezencën e prindërve dhe çdo individ tjetër brenda në institucion (me përjashtim të nxënësve dhe personelit të deklaruar të institucionit arsimor).
- ✚ Roja i shkollës respekton rregullin që çdo kërkesë për komunikim me drejtuesin e institucionit të bëhet nëpërmjet numrit të kontaktit të drejtorit ose të stafit drejtues.
- ✚ Roja i shkollës, i kryen të gjitha detyrat, duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit dhe mësuesit dhe sanitaret.

C.4 PËR PRINDIN

- ✚ Nënshkruan ose konfirmon në rrugë elektronike, tek mësuesi, apo mësuesi kujdestar, këtë rregullore.
- ✚ Plotëson formularin e vetëdeklarimit ditor me përgjegjësi për gjëndjen shëndetësore të fëmijës në numrin e kontaktit të mësuesit kujdestar.
- ✚ Në rast nevoje për komunikim me mësuesin, apo drejtuesin, përdor vetëm komunikim elektronik.
- ✚ Në rastet e shoqërimit të fëmijës në shkollë, nuk futen brenda mjedisit të shkollës për çfarëdo arsyeje që mund të paraqesë.

C.5 PËR DREJTUESIN

- ✚ Ngre grupe pune dhe hartojn planet e veprimit për menaxhimin e situatës, garantimin e standarteve dhe respektimin e rregullave të përcaktuara me këtë rregullore.
- ✚ Monitorojn pajisjen e nxënësve dhe të stafit me mjete mbrojtëse, si: maskë, doreza, xhel dezinfektues për përdorim personal (sipas mundësive).
- ✚ Mban kontakte, përmes komunikimit elektronik, me njësinë e vetëqeverisjes vendore, njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, struktura e Shëndetit Publik, Policinë e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese për ecurinë e procesit mësimor.
- ✚ Për çdo fëmijë i cili paraqet probleme shëndetësore, si p.sh rritje të temperaturës etj...,apo ka njoftim nga prindi, ka pasur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, si dhe nëse prindi përkatës është i sëmurë, apo ka pasur kontakte me COVID-19, lajmëron menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.
- ✚ Për çdo mësues apo personel tjetër të shkollës, i cili paraqet problem shëndetësore, si: p.sh rritje të temperaturës etj., ka njoftim se ka patur dikë të prekur me COVID-19, lajmëron menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.

Ky udhëzues/rregullore, hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI
Teuta BRAÇAJ